



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 34 21 – 27 Gusht 2023

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 NJVKSH ose 100% (=36/36) e tyre

35 NJVKSH ose 97% (=35/36) e tyre kanë raportuar në platformën dixhitale SISI:

BERAT, BULQIZË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIË, KUÇOVË, KUKËS, KURBIN, LEZHË, LIBRAZH, LUSHNJE, MALLAKASTËR, M. MADHE, MAT, MIRDITË, PEQIN, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, 1 NJVKSH ose 3% (=1/36) e tyre: HAS

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 34

	JAVA 34
DIARRE PA GJAK	4.262
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	6.185
INF. RESP. TE POSHTËME	2.185
RASH ME TEMPERATURË	17
VERDHEZA	0
ETHE E ZGJATUR E PASHPJEGUAR (> 3 JAVE)	0
ANOMALI KONGENITALE	0
KONJUKTIVIT AKUT TEK NEONATËT	0
Numri i Njësive Raportuese	413
% e Njësive Raportuese	9.% (404/446)

Rash me temperaturë


Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog rastet e mëposhtëme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për varicelë dhe dorë-këmbë-gojë:

Fier – 3 raste


Tiranë –14 raste

Infeksione respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet 10% ritje në javën 34 krahasuar me javën paraardhëse, java 33.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet ritje në javën 34 krahasuar me javën paraardhëse, java 33.

Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 25 - 34 të vitit 2022 dhe 2023. Numri i rasteve.




Në javën 34 të vitit 2023 vërehet prirje në ritje e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme.

Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas NJVKSH në javën 33 dhe 34 / 2023. Incidenca (raste/10.000)




Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët 25 - 3 të vitit 2022 dhe 2023. Numri i rasteve.



Në javën 34 të vitit 2023 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 33 dhe 34 / 2023. Incidenca (raste/10.000)



Nga komunikimi me NJVKSH shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Ngjarje ndërkombëtare

1. *Botulizmi – Spanjë – 2023*

- Më 13 gusht 2023, autoritetet shëndetësore norvegjeze informuan për dy raste të botulizmit në individë që vizituan Barcelonën midis 10 dhe 23 korrikut, dhe konsumuan omëletë të paketuara me patate.
- Që nga data 23 gusht 2023, 11 raste të botulizmit (gjashtë të konfirmuara, pesë të mundshme) janë raportuar në individë me konsumim të omëletave me patate të paketuara nga marka dhe supermarkete të ndryshme, në komunitete të ndryshme autonome spanjolle.
- Neurotoksina e tipit B është identifikuar në tre nga rastet e konfirmuara.
- Produktet e dyshuara janë shpërndarë në Andorra, Francë dhe Portugali.
- Bazuar në informacionin aktual, rreziku i infeksionit për qytetarët e BE/EEA konsiderohet i ulët, megjithëse mund të ndodhin ende raste të tjera të lidhura me këtë ngjarje.

2. *Rastet autoktone të Dengës - Itali - 2023*

- Katër raste të etheve denge autoktone janë zbuluar që nga java e parë e gushtit në rajonet e Lombardisë (3 raste) dhe Lacios (1 rast). Këto u raportuan në ECDC nga autoritetet italiane të shëndetit publik më 18, 21 dhe 24 gusht 2023.
- Në pritje të hetimeve të mëtejshme mikrobiologjike, deri më sot, hetimet epidemiologjike nuk kanë identifikuar ndonjë lidhje midis rasteve në Lombardi dhe rastit të identifikuar në Rajonin e Lazios.
- Masat e reagimit dhe kontrollit po zbatohen nga autoritetet italiane të shëndetit publik. Këto përfshijnë gjetjen e rasteve, aktivitetet e kontrollit të vektorëve, informacionin për ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe publikun e gjerë, dhe masat parandaluese për dhuruesit e gjakut.
- Raste të tjera autoktone mund të ndodhin në Itali dhe survejanca duhet të forcohet për të përcaktuar më tej zonat në rrezik, dhe për të matur nivelin e rrezikut.
- Meqenëse vektori mushkonja *Aedes albopictus* është gjetur në pjesën më të madhe të Evropës, futje të mëtejshme të virusit që çojnë në transmetime dytësore autoktone mund të ndodhin në shumicën e vendeve të BE/EEA

3. *Sëmundja e Legjionarëve – Poloni – 2023*

- Më 25 gusht 2023, Inspektori Sanitar Shtetëror i Qarkut në Rzeszów, Poloni, raportoi një shpërthim të vazhdueshëm të sëmundjes së legjionarëve që përfshin 113 raste të konfirmuara dhe shtatë vdekje.
- 113 individët banojnë në vendet e mëposhtme: Rzeszów (78), Rzeszów powiat (23), RopczyckoSędziszów powiat (3), distrikti Dębica (3), distrikti Łańcut (2), distrikti Przeworsk (1), distrikti Nisko (1), distrikti Przemyśl (1) dhe distrikti Stalowa Wola (1).
- Po zhvillohen hetime epidemiologjike dhe mjedisore për të përcaktuar burimin e shpërthimit dhe për ta kontrolluar atë.

4. *Survejanca sezonale e virusit të Nilit Perëndimor– 2023*

- Që nga përditësimi i fundit dhe deri më 23 gusht 2023, 104 raste humane të infeksionit me virusin e Nilit Perëndimor (WNV) janë raportuar nga vendet e BE/ZEE dhe 15 nga vendet fqinje me BE-në.
- Që nga fillimi i sezonit të transmetimit 2023, 229 raste njerëzore të infeksionit WNV janë raportuar nga vendet e BE/EEA dhe 39 nga vendet fqinje të BE-së.
- Trembëdhjetë shpërthime midis ekuidëve dhe 60 shpërthime midis shpendëve janë raportuar nga vendet e BE/EEA që nga fillimi i sezonit të transmetimit të WNV 2023 dhe që nga 23 gusht 2023.

5. *Chikungunya dhe ethe Dengue –Monitorimi i shpërthimeve globale*

- Në vitin 2023 dhe që nga 23 gushti, rreth 320 000 raste dhe mbi 340 vdekje janë raportuar në mbarë botën si rezultat i sëmundjes së virusit chikungunya. Shumica e rasteve ndodheshin në Amerikën e Jugut.
- Në vitin 2023, dhe që nga 23 gushti, mbi 3.7 milionë raste dhe mbi 2 000 vdekje të lidhura me Dengën janë raportuar globalisht.
- Në korrik dhe gusht 2023, në Evropë janë raportuar gjashtë raste të dengës autoktone/jo udhëtimi, nga Franca (2) dhe Italia (4).
- Asnjë rast autokton i sëmundjes së virusit chikungunya nuk është raportuar deri më sot këtë vit.
- Mundësia aktuale e ngjarjeve lokale të transmetimit të viruseve chikungunya dhe dengës që ndodhin në zonat ku vektori është i pranishëm në kontinentin e BE/EEA është i lartë, pasi kushtet mjedisore janë të favorshme për aktivitetin e vektorit dhe replikimin e virusit në vektorë.

Ngjarje kombëtare

6. *Raste me S. intoksikacion alimentar, Vlorë 26.08.2023*

- Nga hetimi epidemiologjik i kryer nga shërbimi i Njësia Vendore a Kujdesit të Shëndetit (NJVKSH) Vlorë në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU) dhe me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) rezulton, se një grup fëmijësh polakë të ardhur për kamp veror që prej datës. 19.8.2023 në Grand Land resort në Barbullush, kanë kryer në datë 25.8.2023 udhëtim me anije në Vlorë në gji (Sazan, Karaburun).
- Pas konsumit të drekës së servitur në anije kanë shfaqur shenja klinike të një helmimi ushqimor me: Këputje (84%), nause (84%), dhimbje barku (81%), të vjella (73%), cefale (71%), temperaturë (45%), diarre (34%). Rastet u hospitalizuan në Spitalin Vlorë dhe Memorial në Fier.
- Në datë 26.8.2023 gjendja e tyre është përmirësuar, kanë dalë nga spitali me asnjë pasojë të rëndë klinike.
- Burimi i mundshëm i infektimit mendohet të jetë konsumi i drekës në anijen Black Pearl në datë 25.8.2023. Ushqimi më i përdorur dhe më i mundshëm ishte fileto pule. Klinika ka filluar mesatarisht rreth 3 orë pas konsumit të drekës.
- Nga ISHP-ja është konfirmuar shkaktari *Norovirus* në mostrat e feceve të personave të sëmurë të dërguara në laboratorin e virologjisë